



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 8, date 30.1.2018

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET E Z.GJERGJ NDOU, KATRINE NDOU DHE MUHAMET KAÇIRANI, BANESAT E TË CILËVE JANË DËMTUAR NGA ZJARRI

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 30.1.2018, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenet 54 shkronja “dh”, 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.8756, datë 26.03.2001 “Për Emergjencat Civile”, i ndryshuar, VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKB nr. 85, datë 26.12.2017 “Për buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2018”, Shkresa nr. 3950 prot, datë 21.06.2017 e Ministrisë së Punëve të Brendshme,

V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënie e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Gjergj Ndou** në vlerën prej **80,000 lekë (tetëdhjetë mijë)**, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
2. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënie e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së znj. **Katrine Ndou** në vlerën prej **20,000 lekë (njëzet mijë)**, për dëmtimin e banesës nga zjarri.
3. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënie e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Muhamet Kaçirani** në vlerën prej **80,000 lekë (tetëdhjetë mijë)**, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.

4. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile në programin 10910 parashikuar në buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2018 të miratuar me VKB nr.85, datë 26.12.2017, në programin P13, F1 O1 A2. (transferime tek individë).
5. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër.
6. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 1,894,634 lekë (një milion tetëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër) dhe atë në orendi, mobilje e pajisje elektroshtëpiake në vlerën 424,300 lekë (katërqind e njëzet e katërmijë e treqind) sipas preventivava të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z.**Gjergj Ndou dhe Katrine Ndou, në total 2,318,934 lekë (dy million e treqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër)**
7. Miratimin e vlerës së dëmit nga ana ndërtimore në vlerën 166,458 lekë (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë) sipas preventivava të Komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e z.**Muhamet Kaçirani.**
8. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, Ministrisë së Punëve të Brendshme për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për familjet e z. Gjergj Ndou, Katrine Ndou, dhe familjes së z. Muhamet Kaçirani, sipas përcaktimeve të VKM-së nr.329, datë 16.05.2012, për shkak të pamundësisë së bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën.
9. Ngarkohet administrata e bashkisë Shkodër të bëjë likuidimin e shumës prej 180,000 lekë.
10. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
11. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 30.1.2018


Shpallur në datën 31.1.2018

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI